



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr.95  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303  
Prishtinë, më 14 maj 2024, në orën 11:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fatmire Kollçaku, Armend Zemaj, Labinotë Demi- Murtezi, Haxhi Avdyli, Mirsad Shkreta, Burim Meta, Bekim Haxhiu, Floretë Zejnullahu dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

**Mungoi :** Shemsedin Dreshaj, anëtar.

**Pjesëmarrës të ftuar :** Burim Uka, shef i Shërbimit të Fizikës Mjekësore në Klinikën e Onkologjisë, SHSKUK; Donjeta Kelmendi, drejtoreshë e Koalicionit të Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve, KOMF.

**Stafi mbështetës:** Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë/analist.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Sehad Kadriu dhe Fesal Selimi nga Klinika e Onkologjisë- SHSKUK; Remzije Krasniqi, Rexhep Gojnovci, Gani Lluga dhe Ibadete Krasniqi- KOMF

**Mbledhjen e kryesoi** Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takim me përfaqësues të Shërbimit të Fizikës Mjekësore SHSKUK; (11:00-12:00)
3. Takim me përfaqësues të KOMF (12:00-13:00)
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

**Fatmire Kollçaku**, tha se sot po i takojmë përfaqësuesit e Shërbimit të Fizikës Mjekësore, që janë në kuadër Klinikës e Onkologjisë, brenda SHSKUK-së, lidhur me rëndësinë që kanë këta ekspertë në ofrimin e shërbimeve dhe trajtimin e pacientëve, si dhe për sfidat me të cilat ballafaqohen, si kuadër deficitar. Për të paraqitur kërkesën e tyre është i ftuar z. Burim Uka, Shef i Shërbimit të Fizikës Mjekësore në Klinikën e Onkologjisë.

**Burim Uka, Shef i Shërbimit të Fizikës Mjekësore në Klinikën e Onkologjisë- SHSKUK,** e paraqiti kërkesën si ne vijim; Vlerësojmë nevojën imediate të trajtimit të fizikanëve mjekësorë si staf meritator profesional mjekësor, e që fatkeqësisht me ligjin aktual të pagave kjo kategori profesionistësh janë diskriminuar. Fizikanët mjekësorë, të punësuar pranë SHSKUK-së, kanë përgatitje të lartë profesionale-shkencore dhe edukim specialistik në këtë fushë, dhe ushtrojmë detyra specialistike të kësaj fushe brenda Klinikës së Onkologjisë, përkatësisht në Repartin e Radioterapisë, me përgjegjësi dhe kompetencë të lartë profesionale. Në mbarë botën, por edhe tek ne në Kosovë, ekzistojnë dy nivele të fizikanëve të punësuar në qendra të ndryshme mjekësore. Pra, janë ekspertët e Fizikës Mjekësore, që kanë kompetenca për të realizuar plane trajtimi dhe aprovuar terapi për trajtimin e pacientëve, e të cilët gjithashtu kanë licencë pune, dhe janë Fizikanët Mjekësorë, të cilët punësohen në qendra spitalore pas mbarimit të studimeve Master në Fizikë Mjekësore, apo Fizikë dhe të cilët më pas ju caktohet mentori klinik, japin kollokuiume dhe fare në fund (pas 3 vjetësh nën mentorim klinik) marrin njohjen e Ekspertit të Fizikës Mjekësore. Derisa Fizikanët Mjekësorë nuk e marrin njohjen, për 3 vjet të plota punojnë nën përgjegjësinë profesionale dhe mbikëqyrjen e Ekspertit të Fizikës Mjekësore, gjë që e kanë të rregulluar edhe me kontratën e punës. Kjo çështje rregullohet me anë të Rregullores për Edukimin, Trajnimin dhe Njohjen e Shërbimeve dhe Ekspertëve. Shërbimi i Fizikës Mjekësore në Klinikën e Onkologjisë ka të punësuar tre ekspertë të Fizikës Mjekësore, katër fizikanë mjekësorë, ndërsa në Shërbimin e Mjekësisë Nukleare dhe në Klinikën e Radiologjisë janë të punësuar dy ekspert të Fizikës Mjekësore.

Gjatë vitit 2023, Shërbimi i Fizikës Mjekësore në Klinikën e Onkologjisë, sipas të dhënave zyrtare, ka kryer 11.839 shërbime profesionale mjekësore. Ndërsa, vetëm gjatë muajit të fundit janë kryer 1.995 shërbime mjekësore nga po ky shërbim. Ajo për çka realisht ne kemi ardhur këtu, është për t'ju informuar se gjatë shqyrtimit të parë të Projektligjit të pagave, kur ligji ka dalë në diskutim publik, ne si kategori profesionistësh kemi qenë të ranguar bashkë me specialistë tjerë (mund të shihni dokumentin që gjendet në faqen zyrtare), ndërsa pas aprovimit të ligjit, Eksperti - term ky i barasvlershëm gjuhësisht me specialist, është ranguar me koeficient 8, ndërsa të gjithë specialistët tjerë, përfshirë edhe psikologun klinik, janë ranguar me koeficient 12. Andaj, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, tre Ekspertë të Fizikës Mjekësore, kanë dhënë dorëheqjen, gjë që ka rrezikuar shumë seriozisht ekzistencën dhe kualitetin e terapisë me rrezatim. Meqenëse edhe nga këta tre Ekspertë të mbetur, kam paralajmërimë të vazhdueshme për dorëheqje, për ta shpëtuar një shërbim shumë vital për pacientët, duke pasur parasysh që edhe nuk ka implikime të mëdha buxhetore, sepse bëhet fjalë për pesë persona, edhe në dhjetë vitet e ardhshme nuk do bëhen më shumë se dhjetë persona, ju lutemi që t'i rekomandoni Ministrisë së Punëve të Brendshme që Ekspertët e Fizikës Mjekësore të rangohen me gjithë specialistët tjerë, ndërsa fizikanët mjekësorë të rangohen me specializantë tjerë, pasi që të tillët janë në proces specializimit.

**Sehad Kadriu, Ekspert i Fizikës Mjekësore, Klinika e Onkologjisë,** tha se kategoria Ekspert i Fizikës Mjekësore, është diskriminuar më anë të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, duke

pasuar parasysh faktin që kjo kategori janë ekspert të një fushë veçantë, specifike që me numër jemi pak dhe se rritja e koeficientit nuk do të kishte implikim të madh në buxhet.

**Bekim Haxhiu**, pyeti së sa është koeficienti i ekspertit të Fizikës Mjekësore, tani pas miratimit të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik ?

**Sehad Kadriu, Ekspert i Fizikës Mjekësore, Klinika e Onkologjisë**, tha së ata janë kategorizuar me koeficient 8 dhe së kriteri minimal i shkollimit për të marre titullin ekspert është të keni përfunduar masterin –MA.

**Haxhi Avdyli**, pyeti se ne cilin kategori të koeficientit e keni propozimin për të qenë?

**Sehad Kadriu, Ekspert i Fizikës Mjekësore, Klinika e Onkologjisë**, tha pasi që brenda SHSKUK-së, nuk ka koeficient në mes 8-shit dhe 12-shit, në qoftë së ka diçka të ndërmjet 8-shit dhe 12- shit do të ishte e udhës sikurse që kanë koeficientin profesor asistent.

**Armend Zemaj**, pyeti sa është numri i eksperteve të Fizikës Mjekësore që punojnë tash që kanë mbetur duke punuar ne Klinikën e Onkologjisë?

**Burim Uka, Shef i Shërbimit të Fizikës Mjekësore ne Klinikën e Onkologjisë- SHSKUK**, tha se kanë qenë 6 Ekspertë të Fizikës Mjekësore, që kanë punuar në Klinikën e Onkologjisë, 3 e kanë lëshuar punën, tash kemi mbetur vetëm edhe 3.

**Armend Zemaj**, cili është komunikimi i juve më SHSKUK-në, kur 3 prej ekspertëve të Shërbimit të Fizikës Mjekësore e kanë lëshuar punën nga Klinika e Onkologjisë, cila është përgjigjja e SHSKUK-së lidhur më këtë problematikë? Sa i përket kategorizimit për koeficient, tha së në këtë drejtim ne si komision, mund të kontribuojmë vetëm nëse Qeveria e sjellë plotësim ndryshimin e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik.

**Burim Uka, Shef i Shërbimit të Fizikës Mjekësore ne Klinikën e Onkologjisë- SHSKUK**, sqaroi se fillimisht në draft ligjin për Pagat në Sektorin Publik, kemi qenë në kategorinë specialist. Ndërsa këta 3 koleget që kanë lëshuar punën nga Klinika e Onkologjisë, janë edhe profesor dhe për arsyeje të koeficientit që lartë atje, e kanë lëshuar punën nga Klinika e Onkologjisë dhe për këtë shkak ju drejtuam komisionit, që kjo kategori të mos lihet pas dore dhe që shërbimi Fizikës Mjekësore ne Klinikën e Onkologjisë, të mbetet funksional dhe të mos mbyllet.

**Bekim Haxhi**, tha që këto probleme i kemi pasur të njohura edhe kur është miratuar Ligji për Pagat në Sektorin Publik, lidhur më këtë kategori dhe për kategoritë tjera, kam propozuar amendamente që koeficienti të jetë 8.5, por që nuk janë përkrahur nga shumica parlamentare. Ju duhet të kategorizoheni në një pozitë më meritorë më koeficient, tani çka mundemi më bërë ne si komision në këtë rast, është vetëm nëse vjen për plotësimi dhe ndryshim i Ligjit për Pagat në Sektorin Publik. Çka do të ndodh nëse edhe ju 3 jepen dorëheqje nga Shërbimi i Fizikës Mjekësore ne Klinikën e Onkologjisë?

**Burim Uka, Shef i Shërbimit të Fizikës Mjekësore ne Klinikën e Onkologjisë- SHSKUK,** tha që i kanë punësuar edhe 4 Fizikanë mjekësor por që janë në fazën fillestare të punës së tyre, por nëse ne 3 që jemi me përvojë të gjatë të punës japim dorëheqje, vërtet rrezikohet shërbimi i Fizikës Mjekësore ne Klinikën e Onkologjisë.

**Haxhi Avdyli,** tha së është e vërtetë që duhet shumë kohë për të krijuar kuadër me resurse njerëzore, edhe në rastin e juaj që jeni ekspert të Fizikës Mjekësore, duhet pasur parasysh kërkesat tuaja në ruajtjen e kuadrit për funksionalizim Shërbimit të Fizikës Mjekësore në Klinikën e Onkologjisë. A keni provuar që t'i merreni shtesat mujore, siç i marrin IT-ja, apo për ta gjetur një modalitet që me ju fut në këto shtesa, meqenëse jeni një numri i vogël dhe nuk është kosto e lartë deri në zgjidhjen përfundimtare që duhet të bëhet më ligj? Krahasuar më pagën që e keni pasur, para hyrjes në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, a keni pasur rritje apo zvogëlim?

**Burim Uka, Shef i Shërbimit të Fizikës Mjekësore ne Klinikën e Onkologjisë- SHSKUK,** tha së ka pasur rritje më ligjin që tani është fuqi. Sa i përket shtesave, kjo çështje duhet të rregullohet më ndryshimin e rregullores për shtesa të rrezikshmërisë, pasi që jemi vetëm 3 ekspertë dhe nuk ka implikim të madh buxhetor.

**Mirsad Shkreta,** sa i përket Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, tha së është suksesi më madh që ndodhur për specialistet e mjekësisë, kur dihet së paga e mëhershme ka qenë rreth 700 euro, ndërsa tash pas miratimit të këtij ligji paga është rreth 1200 euro, andaj ky ligj e ka dhënë efektin e vet, por pajtohemi së ka padrejtësi për disa kategori që në të ardhmen duhet te korrigjohen. Ne si Komision, për aq sa kemi kompetenca do ta adresojmë kërkesën tuaj në Qeveri, në mënyrë që të rregullohet kategoria e Eksperteve të Fizikës Mjekësore.

**Burim Meta,** tha të gjitha kategoritë e ekspertëve në këtë rast dhe të këtyre Eksperteve të Fizikës Mjekësore, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, sa i përket kategorisë së koeficienteve që më anë të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik. Ju duhet të trajtoheni më mire dhe e përkrahu propozimin e kolegut Haxhi Avdyli, që të provoni për ta gjetur një modalitet për shtesa mujore.

**Labinotë Demi- Murtezi,** ju më herët e potencuat së në draftin e Projektligjit për Pagat në Sektorin Publik, propozimi i ka qenë kategoria e Ekspert i Fizikës Mjekësore të këtë koeficient më të lartë, cili ka qenë koeficienti?

**Burim Uka, Shef i Shërbimit të Fizikës Mjekësore ne Klinikën e Onkologjisë- SHSKUK,** tha draftin e Projektligjit për Pagat në Sektorin Publik, propozimi ka qenë 11, por në fund kur është miratuar nga Qeveria ka mbetur 8. Ju falënderojmë që na dëgjuat, duke shpresuar shumë sinqerisht që do të kemi përkrahjen tuaj.

**Fatmire Kollçaku,** tha në baza të kërkesës dhe të diskutimeve, një ndër shqetësimet kryesore të Shërbimit të Fizikës Mjekësore, që funksionojnë në kuadër të Klinikës të Onkologjisë, është edhe koeficienti me të cilin janë vlerësuar, në bazë të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, këto probleme dhe kërkesën e juve, do ta adresojmë tek institucionet relevant, fillimisht në Ministrinë e Shëndetësisë. E kuptojmë rëndësinë e juve në Klinikën e Onkologjisë, ne do të angazhohemi lidhur edhe me rrezikshmërinë që e keni në vendin e punës dhe kemi vlerësim në profesionalizimin e juaj.

### **3. Takim me përfaqësues të KOMF (12:00-13:00)**

**Fatmire Kollçaku**, tha se këtë takim me përfaqësuesit e KOMF-it po e realizojnë në prag të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, për të diskutuar lidhur me shërbimet sociale për fëmijët dhe familjet në Kosovë. Ajo tha, se me Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të familjeve – KOMF, kemi bashkëpunuar dhe në të kaluarën, lidhur me aktivitetet që i ka në fushëveprim Komisioni, po ashtu, e kemi pasuar edhe një bashkëpunim ngushtë me ta edhe në vitin e kaluar 2023, gjatë kohës së shqyrtimit të Projektligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare. Për të diskutuar për këtë temë fjalën ia kaloi znj. Donjeta Kelmendi, drejtoreshë e Koalicionit të Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve, KOMF.

**Donjeta Kelmendi, drejtoreshë e Koalicionit të Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve, KOMF**, njoftoi lidhur me gjendjen e shërbimeve sociale, të arriturat, sfidat në ofrimin e shërbimeve si dhe për propozimet apo hapat që duhet të ndiqen për përmirësimin e situatës së ofrimit të shërbimeve të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet në Kosovë. Ajo tha, se organizatat që merren me shërbimet sociale për fëmijët dhe familjet në Kosovë, janë duke ballafaquar me sfida. Organizatat tani janë duke funksionuar me rreth 66 për qind të buxhetit, përderisa shërbimet ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara, kanë mbështetje financiare me rreth 21 për qind të financimit. “Sigurisht që kemi pasur një bashkëpunim të mirë me Komisionin tuaj. Vetë miratimi i Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, i cili sjell një shërbim të ri në fushën e shërbimeve sociale, është një hap shumë i madh dhe në bashkë me organizata anëtare e kemi cilësuar një ndër arritjet më të mëdha në tre- katër vitet e fundit. Organizatat anëtare të koalicionit KOMF, pjesa dërrmuese e tyre janë ofruese të shërbimeve sociale direkt, qoftë për fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët me aftësi të kufizuara, viktimat të dhunë dhe abuzimit, viktimave të trafikimit, janë në dispozicion çdo ditë, madje shërbimet rezidenciale janë 24 orë në shërbim të fëmijëve”. Sa i përket mbrojtjes së Fëmijëve, që është respektimi, mirëqenia dhe avancimi i të drejtave të fëmijëve dhe familjeve, tha se janë të pakënaqur me mbështetjen e institucioneve vendore. Ajo theksoi, se organizata që operojnë në Kosovë, mbështetjen më të madhe e kanë nga donatorët. “Ka sfida, Kosova ka zgjedhur modelin e ofrimit të shërbimeve sociale për fëmijë dhe familje, sistem i modelit të kombinuar. Në Kosovë janë rreth 50 organizata joqeveritare të cilat janë ofruese të shërbimeve sociale. Punojnë në vazhdimësi me fëmijë dhe familje. Këto organizata të licencuara mbështetjen më të madhe deri me tani e kanë pasur nga donatorët. Kanë pasur mbështetje edhe nga institucionet publike, mbështetje kohëpaskohshme ka pasur nga disa komuna. Me një financim të kombinuar kanë vazhduar që të ofrojnë shërbime. Situata është përkeqësuar nga janari i viti 2024 dhe arsye është se programet dhe projektet që kanë qenë të dedikuara për shërbime sociale kanë përfunduar në dhjetor të vitit 2023. Me mbylljen e këtyre programeve, është krijuar një çrregullim i shërbimeve. Sepse një pjesë e ofruese të shërbimeve kanë mbyllur shërbimet, ndërsa një pjesë tjetër kanë reduktuar numrin e përfituesve”. Ajo tha, se aktualisht shërbimet rezidenciale, janë rreth 66 për qind që kanë buxhete për të funksionuar, ndërsa shërbimet ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara, kanë mbështetje financiar me rreth 21 për qind të financimit, është vështirë me vazhduar si ofrues të shërbimeve. Tani në situatë që jemi, është një numër i fëmijëve dhe familjeve që nuk marrin shërbime. Duke pasur parasysh këtë situatë kemi bërë kërkesë te ministri i Financave, Kryeministri, por edhe të ministrja e Drejtësisë, për krijim e një

mase të përkohshme për funksionalizimin e shërbimeve sociale në kuadër të pakos për ringjallje ekonomike. Kjo është një zgjidhje ad-hoc, këtë e kemi parë si mundësi që ta tejkalojmë këtë sfidë, lidhur më këtë kërkesë që kemi adresuar ende nuk kemi marrë përgjigje

**Remzje Krasniqi, SOS fshatrat e fëmijëve në Kosovë,** tha se e kemi të pamundur për më ofruar shërbime për fëmijët pa përkujdesje prindërore pa mbështetjen financiare të shtetit edhe ne mungesë të fondeve dhe të një buxhet të qëndrueshëm, e kemi të pamundur të pranojmë fëmijë të tjerë për strehim 24 orë. “Një nga porosinë që vjen nga organizata jonë, është se çka do të ndodh me shërbimin 24 orësh në vitet në vazhdim. Ne i kemi informuar edhe qeverinë që në vitet në vazhdim në pamundësinë për të strehuar numër të ri të fëmijëve dhe lisat pritjes është e gjatë, në pamundësi të fondeve dhe një buxhet të qëndrueshëm, e kemi të pamundur të pranojmë fëmijë të tjerë përveç këta që i kemi. Një shpenzim mujor për një fëmijë tek ne, përafërsisht ka koste deri në 850 euro, përderisa në marrim 44 euro nga subvencione nga Qeveria. Kjo e rrezikon çdo muaj mbulimin e shpenzimeve”, Për te ardhmen shteti duhet intervenuar që shërbimet sociale për fëmijët përkujdesjen 24 orë ta marrin përsipër, sepse donacionet e fondeve të OJQ-ve janë duke u zvogëluar.

**Rexhep Gojnovci, nga KOM,** tha se mbështetja e nivelit komunal për shërbimet sociale, është formë të subvencioneve dhe duhet të rritet mbështetja financiare në bazë të ndarjeve buxhetore për çdo vit, më anë të Ligjit për buxhetin vjetor, pasi që këto kategori sociale rrezikohen në mungesë të buxhetit të qëndrueshëm, sepse fondet e OJQ-ve janë zvogëluar që janë donacione të ndërkombëtarëve, prandaj, tash duhet të veprojnë dora e shtetit, duke e marrë përsipër financimin e shërbimet sociale për fëmijët dhe familjet në Kosovë.

**Gani Lluga, nga KOMF,** foli për rrezikun e mbylljes së OJQ-ve, që i ofrojnë shërbimet për fëmijët e braktisur dhe më aftësi të kufizuar në qëndrim ditor, kërkoi që këto shërbime të merren përsipër nga Qeveria, duke dedikuar buxhetin për shërbime sociale dhe familjare, sepse përndryshe këto shërbime do të mbyllen nga OJQ-të, prandaj, shteti duhet ta ketë për bazë financimin e këtyre shërbimeve, ne si Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, jemi të gatshme në këtë drejtim të bashkëpunojmë me institucionet përkatëse, sepse ne Kosovë të drejtat e fëmijëve janë në rrezik, në mungesë të shërbimeve sociale, që për çdo ditë po mbyllen në mungesë të një financimi të qëndrueshëm.

**Fatmire Kollçaku,** sqaroi sa i përket Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare pritshmëritë janë se nga viti i ardhshëm të jetë një situatë më e mirë financiare për këto organizata, pasi që ky ligj krijon një bazë ku ndan për here të parë nivelet e shërbimeve sipas ligjit. Se kur kemi një ligj që parasheh një kosto financiare, ne shpresojmë që ato shërbime sociale do të shkojnë paralel në bazë të buxhetit të planifikuar.

**Labinothë Demi- Murtezi,** sa i përket Projektligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare i cili tash është miratuar, kemi pasur bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë më ju, Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF. Ajo tha, se edhe po të financohen 100% shërbimet sociale dhe familjare, prapëseprapë nevoja është e madhe, është fakt që po rritet buxheti, por fatkeqësisht, por po rritet edhe më shumë nevoja për këto shërbime sociale, prandaj duhet ta gjejmë një balancë që këto shërbime të mos mbyllen për mungesë të fondeve.

**Donjeta Kelmendi, drejtoreshë e Koalicionit të Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve, KOM,** sqaroi se për gjitha këto shërbime sociale, i kemi adresuar tek Ministria e Drejtësisë, kostot buxhetore për secilin shërbim veç e veç.

**Mirsad Shkreta,** tha që këto shërbime sociale janë trajtuar në bazë të buxhetit që e kanë disponuar institucionet përkatëse. Pajtohemi së këto kategori nuk duhet të lihen vetëm në margjinat e shoqërisë, por gradualisht të kalojnë në dorën e shtetit dhe buxheti duhet të ndahet në bazë të formulës së kostos së shpenzimeve, po ashtu, duke e rregulluar dhe strukturën e monitorimit të këtyre shpenzimeve.

**Donjeta Kelmendi, drejtoreshë e Koalicionit të Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve, KOM,** sa i përket financimit të shërbimeve sociale, krahasuar me vitet e fundit, tha se Ofruesit e shërbimeve sociale në vitin 2024, janë në gjendje më të rëndë. Kjo për arsyen, që në dhjetor të vitit 2023, për pjesën dërrmuese, kanë përfunduar programet dhe projektet e donatorëve ndërkombëtarë, në mbështetje të shërbimeve sociale, duke lënë zbrazëtira të mëdha në financimin e shërbimeve sociale. Në anën tjetër, Komunitat nuk po arrijnë të financojnë shërbimet sociale, përkundër që shërbimet sociale janë decentralizuar që nga viti 2009. Në këtë situatë, KOMF e kërkoi mbështetjen e komisionit që në procesin e rishikimit të Ligjit për Buxhet për vitin 2024, të ngritin zërin që të ndahet buxhet për shërbime sociale për të tejkaluar këtë situatë emergjente. Ajo kërkoi që anëtarët e Komisionit të avokojnë të Qeveria për krijimin e një mase të përkohshme në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për funksionalizimin e shërbimeve sociale për këtë vit.

**Fatmire Kollçaku,** i falënderoi për gatishmërinë e bashkëpunimit dhe i përgëzoi për punën që kanë bërë dhe janë duke e bërë në misionin e tyre në mbrojtjen e Fëmijëve. Ajo tha, që Organizatat joqeveritare që merren me mbrojtjen e fëmijëve, e kanë të pamundur funksionimin e tyre me buxhetin aktual, lidhur më këtë çështje kërkoi që për të gjetur zgjidhje emergjente, të dërgoni edhe më shkrim kërkesën, në mënyrë që Komisioni ta këtë më të letë që të avokojnë të institucionet përkatëse për ndarje të buxhetit.

#### **4. Të ndryshme.**

*Për pikën të ndryshme nuk pati ndonjë çështje për diskutim.*

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

**Fatmire Kollçaku,**

**Kryetare e Komisioni**

---

